

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k, NIPT J72124001N me adresë: Autostrada Tiranë - Durrës, Kashar, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar, me mjete elektronike, mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: NR.REF-80184-09-15-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje artikuj kancelarie për KESH sh.a”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.80, datë 25/09/2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1) “InfoSoft Office” sh.p.k, NIPT J62426002Q, pa vlerë të ofertës ekonomike.
- 2) “Librari Dyrrahu” sh.p.k, NIPT L91418502J, me vlerë të ofertës ekonomike 1,520,000 (Një milion e pesëqind e njëzetë mijë) Lekë pa TVSH;
- 3) “Marketing & Distribution” sh.p.k, NIPT J72124001N, me vlerë të ofertës ekonomike 2,296,831 (Dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e një) Lekë pa TVSH;

I- Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1- Operatori Ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k, NIPT J62426002Q pasi nuk plotëson kriteret e mëposhtme:

✚ Nuk ka paraqitur Formularin e ofertës ekonomike sipas shtojcës 1;

✚ Lista e cmimeve të artikujve sipas shtojcës 2 nuk është e saktë pasi nuk është e plotësuar me të gjitha elementet e kësaj shtojce. Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës;

- ✚ Nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.2, pasi nuk ka paraqitur ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- ✚ Nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.7, pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për artikujt objekt prokurimi;
- ✚ Nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.8, pasi nuk ka paraqitur për artikullin Letër A 4 (zëri nr.14 i specifikimeve teknike) skedën teknike të çertifikuar nga prodhuesi/distributori i autorizuar;
- ✚ Nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.9, pasi nuk ka dorezuar në datën dhe orën e hapjes së kësaj procedure mostrat e kërkuara.

2- Operatori Ekonomik “Librari Dyrrahu” sh.p.k, pasi nuk plotëson kriteret e mëposhtme:

- ✚ Nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.4, pasi nuk ka paraqitur deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të të gjithë artikujve në adresat e përcaktuara në planin e shpërndarjes sipas kërkesave dhe nevojave të Autoritetit Kontraktor.
- ✚ Nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.5, pasi nuk ka paraqitur deklaratë se mallrat janë të rinj, të pa përdorur.
- ✚ Nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.6, pasi nuk ka paraqitur deklaratë për periudhën e garancisë së mallrave objekt prokurimi.
- ✚ Nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.7, pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për artikujt objekt prokurimi.
- ✚ Nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.8, pasi skeda teknike e paraqitur për artikullin Letër A 4 (zëri nr.14 i specifikimeve teknike) nuk plotëson kërkesat teknike me specifikimet e kërkuara.
- ✚ Lista e çmimeve të artikujve sipas shtojcës 2 nuk është e saktë pasi Operatori Ekonomik ka bërë ndryshime në përmbajtje të emërimit Zëri 25 i specifikimeve teknike).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “Marketing & Distribution” sh.p.k, NIPT J72124001N, me adresë Autostrada Tiranë - Durrës, Kashar, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 2,296,831 (Dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e një) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor KESH sh.a, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak):

PO JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*): Nuk ka.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ergys Verdho